



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 634 / Prot.
1

Tiranë më, 28.2 .2022

VENDIM

Nr. 07 , datë 21.02.2022

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT
PËR 4 (KATËR) VENDET E PUNËS PËR PERSONEL NDIHMËSAKADEMIK ME
KARAKTER ADMINISTRATIV, NË REKTORATIN E UT-SË**

Sot, në datën 21.02 .2022, bazuar në nenin 66, pika 3, 4, të ligjit të arsimit të lartë nr.80/2015; në nenin 80, pika 1, 2, 7, të Statutit të UT-së; në propozimin e kriterëve të veçanta të njësisë ku personeli ndihmësakademik me karakter administrativ do të shërbejë, sipas strukturës organizative të miratuar të Rektoratit të UT-së; në përshkrimin e pozicionit të punës; Rektori i UT-së, në mbledhjen e tij të datës 21.02.2022, pasi mori në shqyrtim kriteret e propozuara,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e punësimit sipas Lidhjes nr.1, bashkëngjitur këtij vendimi, për 4(katër) vendet e punës, për personel ndihmësakademik me karakter administrativ, në Rektoratit e UT-së, konkretisht:

Në Drejtorinë e Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave:

- 1 (një) vend pune i emërtesës “Përgjegjës në Sektorin e Inovacionit dhe Statistikave”
- 2(dy) vende pune të emërtesës “Specialist në Sektorin e Inovacionit dhe Statistikave”


Në Drejtorinë e Shërbime të Brendshme:

- 1 (një) vend pune i emërtesës “Specialist në Sektorin Juridik”

2. Ky Vendim, së bashku me Lidhjen nr.1 të tij, i përcillet Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme në Rektoratit e UT-së, për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Artan Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Lidhja nr.1

Kriteret e punësimit të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ në Rektoratin e UT-së,

I. Përgjegjës i Sektorit të Inovacionit dhe Statistikave:

Kriteret e përgjithshme:

1. Të jenë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë minimalisht diplomë të nivelit "*Master i Shkencave*", preferohet në fushën e Ekonomiksit, Statistikë Informatike, Informatikës ose Matematikës. Edhe diploma e nivelit "*Bachelor*" preferohet të jetë në të njëjtën fushë.
3. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
4. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna.

Kriteret e veçanta:

1. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 2-vite, preferohet ekesperiencë pune në sektorë të ngjashëm.
2. Të ketë aftësi komunikuese dhe të punës në grup.
3. Të ketë aftësi analizuese dhe përgjithësuese.
4. Të ketë njohuri të mira të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike.
5. Të ketë aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale.
6. Të ketë njohuri të mira në programet kompjuterike të cilat lidhen me fushën e punës, të provuara me dëshmi.
7. Të njohë me dëshmi gjuhën angleze.

II. Specialist i Sektorit të Inovacionit dhe Statistikave:

Kriteret e përgjithshme:

1. Të jenë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë minimalisht diplomë të nivelit "*Master Profesional*", preferohet në fushën e Ekonomiksit, Statistikë Informatike, Informatikës ose Matematikës.
3. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
4. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Kriteret e veçanta:

1. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 1-vit, preferohet ekesperiencë pune në sektorë të ngjashëm.
2. Të ketë aftësi komunikuese dhe të punës në grup.
3. Të ketë aftësi analizuese dhe përgjithësuese.
4. Të ketë njohuri të mira në programet kompjuterike të cilat lidhen me fushën e punës, të provuara me dëshmi.
5. Të njohë me dëshmi gjuhën angleze.

III. Specialist në Sektorin Juridik

Kritere të përgjithshme

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose diplomë ekuivalente me të në Drejtësi. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta

1. Preferohet të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit;
2. Të njohin shumë mirë legjislacionin në fuqi, preferohet atë në arsimin e lartë;
3. Të kenë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit, të provuara me dëshmi;
4. Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze, e provuar me dëshmi;
5. Të kenë aftësi të mira komunikimi, etikë profesionale dhe të dijë të punojë në grup.